



REPUBLIKA E SHQIPËRISË	
MINISTRIA E ARSIMIT DHE	
SPORTIT	
Nësis Org:	Nr. Prot:
Org Jedinica:	Org Prot:
Org Unit:	Prot. No:
Nr. i faqeve:	Data:
Br. stranic:	Data:
No. pages:	

01/B 4061
19.12.24



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja,
Nauke, Tehnologije i Inovacije/ Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation

Nr. 7242/2 Prot., datë 02.12.2024

Nr. 243 Prot., datë 19.12.2024

URDHËR/VENDIM I PËRBASHKËT

NR. 1, DATË 02.12.2024

PËR

MIRATIMIN E AKTEVE RREGULLATORE NË ZBATIM TË MARRËVESHJES “PËR REALIZIMIN E OLIMPIADËS SË PËRBASHKËT NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE”, KLASA E 9-TË, ARSIMI I MESËM I ULËT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 3 të Memorandunit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar, datë 05.07.2023, Urdhrit nr. 556, datë 02.10.2023 “Për caktimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në grupin e përbashkët të punës për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë Shqipe”, klasa e nëntë, arsimit i mesëm i ulët parauniversitar”, Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, nr. 01B-046, dt. 08.05.2024 “Për emërimin e grupit punues”,

URDHËROJ/VENDOS:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të grupit të punës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
2. Miratimin e kalendarit të punës për zhvillimin e olimpiadës, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.

3. Miratimin e rregullores për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit i mesëm i ulët, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
4. Miratimin e kornizës së përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për realizimin e olimpiadës në lëndën e gjuhës shqipe, me nxënësit e klasave të 9-ta në Kosovë dhe në Shqipëri, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri/vendimi.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri/vendimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar/Drejtoritë Komunale të Arsimit, institucionet arsimore parauniversitare (shkollat) dhe grupet respektive të punës.

Ky urdhër/vendim hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR
Ogerta MANASTIRLIU




MINISTËR
Arbërie NAGAVCI

